



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot

Pogradec, me 23.07.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen “Kajo Karafili”,
Geshtenjas, Bashkia Pogradec”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime Ndertimi
45210000-2; Punë Ndërtimi 45000000-7; Punime Ngrohje 45232141-2; Punime Hidraulike
45332200-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 88 879 920 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e
nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti / enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmime të botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe,

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Drejtoria e P.K.ZH.T , u bazua në: projektin e objektit: “Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen “Kajo Karafili”, Geshtenjas, Bashkia Pogradec”, te hartuar nga shoqeria “ INFINITE R S Consulting” dhe specialistet e drejtorisë, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave te punimeve, hartuan preventivin perfundimtar , nga i cili rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë 88 879 920 (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 6 (gjashtë) muaj.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, specialistet e Drejtorise se P.K.ZH.T. u mbështeten në: projektin, preventivin, relacionin teknik dhe të hartuara nga firma projektuese si dhe stafi i Drejtorise se P.K.ZH.T.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga Firma Projektuese dhe Specialistet e Fushes se Drejtorise se P.K.ZH.T.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriteve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në *Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, e ndryshuar .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre përparësi për çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përputhje të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, neni 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të** vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kerkuar për të vertetuar përvojën e meparshme si kontrata e bashkëpunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqeri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në ate status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjale.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe në fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës inxhinier, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ e ndryshuar, si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P – 1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 2 A** Ndërtime civile e industriale;
- **N.P - 3 A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
- **N.P - 12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S -1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dh erifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S – 8 A** Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licensave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP-1 A *Punime gjërmimi në tokë*

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i rikonstruksionit të shkollës 9 vjecare "Kajo Karafili". Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 2 A *Ndërtime civile e industriale.*

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar,

betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Ndërhyrjet objekt kontrate, parashikojnë ndërtimin e shtesës e cila është hartuar duke shfrytëzuar të gjithë ambientet ekzistuese dhe territorin përreth tij. Gjithashtu janë parashikuar zerrat si pllake themeli, trare e bazamente b/a , kollona b/a monolite, trare e arkitrare b/a , soleta dhe mur betoni C20/25 .

Në total vlerat për realizimin e ndërtimit të shtesës anësore dhe strukturave të nevojshme që lidhen me objektin i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

N.P - 3 A Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Sic është parashikuar edhe në projekt kemi të bëjmë me një ndërtese ekzistuese. Për këtë arsye dhe për të plotësuar nevojat e shkollës me klasa dhe me parametra bashkëkohorë është e domosdoshme rikonstrukcioni i shkollës. Këto punime janë parashikuar në preventiv si veshje fasade me polisterol kompakt, cati vendi zakonisht HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi etj. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 3. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Si punime të tilla, në VKM nr. 42 të datës 16.01.2008 *konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.*

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe rripullëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Ndërhyrja objekt kontrate parashikon punime për rikonstrukcionin e godinës së shkollës 9 vjeçare dhe ndërtimin e shtesës me dy kate. Ndërhyrje të tilla përfshihen në veprimtaritë me ndikim në mjedis. Projekti parashikon zhvillime të cilat sjellin detyrimisht ndikime në florën dhe faunën. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për ndërtimin e një objekti, konsistojnë në vija të përgjithshme si më poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në florë/faunë, ç) mbetjet e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, ë) ndikim në peizazhin e zones, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, në fushën mjedisore, i cili i përfshin të tilla aktivitete në aktivitetet me ndikim në mjedis Autoriteti Kontraktor ka realizuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Raportin Teknik të VNM, si dhe ka marrë Vendimin për VNM Paraprake pranë Institucionit

kompetent. Ndikimet në territor nga zbatimi i këtij projekti dhe masat për zbutjen e efekteve shtjellohen në Raportin e VNM.

Masat me efekt financiar për zbutjen e efekteve negative dhe riaftësimin e territorit janë përfshirë në preventivin e punimeve. Në preventiv parashikohen zëra të tillë si: transport materiale ndërtimi, dheu dhe depozitim i mbetjeve në landfill. Këto masa janë të nevojshme për procesin e riaftësimin natyror dhe botanik të territorit të përdorur për ndërtim me mbetje të mëdha inerte. Perpos kesaj ne preventiv eshte parashikuar mbjellja e fidaneve dekorative. Për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe specifikime teknike për riaftësimin e territorit të parcelës ndërtimore është e nevojshme që OE të disponojë licensën përkatëse. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr .42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Projekti i rikonstruksionit të shkollës është shoqëruar me prishjen e rifiniturave dhe shtresave të objektit ekzistues që janë të amortizuar, catia është e amortizuar dhe duhet bere nderrim i saj, suvatimi i brendshëm është i vjetër, i amortizuar, me valëzime dhe e një cilësie të dobët, pllakat e dyshemesë janë të dëmtuara. Për realizimin e rikonstruksionit fillimisht duhet bere prishja e pjeseve të amortizuara. Keto punime janë parashikuar në preventiv, si punime prishje të suvatimit ekzistues në mure dhe tavane, prishje pllakash ekzistuese, çmontim dyer dhe dritare ekzistuese, prishje mur tulle objekti i vjetër, prishje struktura betoni, prishje catie etj. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

Me punime të tilla, sipas VKM nr. 42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron, montimin, mirëmbajtjen ose ristrukturimin e impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Për zbatimin e projekteve të impianteve hidrosanitare dhe atyre të mbrojtjes nga zjarri, të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me

pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla, sikurse parashikohet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 më sipër cituar. Vendosja e këtij kriteri i referohet zgjidhjeve grafike, preventivit, specifikimeve teknike, relacioneve të projektit hidroteknik dhe atij të mbrojtjes nga zjarri, si dhe grafikut të punimeve për zbatimin e projektit total. Në projektet respektive parashikohen impiantet hidrosanitare të furnizimit me ujë të tualeteve dhe të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri të objektit.

Këtu përfshihen të gjitha punimet për instalimin e këtyre rrjeteve, si dhe pajisjet dhe impiantet për vendosjen e tyre në funksion.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr. 42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime murature, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash për izolimin termoakustik dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 B, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla si *montimi në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Këtu përfshihen punimet për veshje fasade me alukobonde, konstruksione metalike te perbera.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 12 A *Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.*

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) *Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.*

Objekti i parashikuar të rikonstruohet dhe shtesa dy kate që do të ndërtohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i kaldajes se propozuar në projekt është konceptuar posaçërisht për funksionin e ndërtesës si objekt i arsimit të 9 vjecar. Impianti i projektuar nëpërmjet këtij projekti është parashikuar - Impiant hidrik primar me prurje variabël dhe sekondar me prurje variable. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi.

Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosija e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 A, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 14 A *Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.*

Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për instalimin e rrjetit elektrik të furnizimit me energji, rrjetin e tokëzimit dhe rrufepritjes, ndriçimin, rrjetin lan ,etj .

Është projektuar që çdo klasë laborator, ambjente të përbashkëta të furnizohen me energji elektrike në mënyrë të pavarur midis tyre, pra me atomat për secilin (të pavarur nga ambjentet e tjera) si dhe rele diferenciale për çdo ambjent . Projekti parashikon dhe ndriçim emergjence për çdo ambjent si dhe ambjentet e përbashkëta. Nga llogaritja e ngarkesave elektrike të projektuar rezulton se fuqia elektrike e instaluar është: $P_{inst}=80.6\text{kw}$ Kjo fuqi e konvertuar me koeficientët rezervë, të njëkohshmërisë dhe të ngarkesës fuqia elektrike e kërkuar do të jetë $P=57\text{kVA}$.

Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuara për realizimin e tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licensa e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S - 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike.

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, *punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Shtesa tre kateshe e objektit të parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|---------------------|--|--|---|--|
| N.P-1 A | Punime gërmimi në tokë | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 8.0 km Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m ³ shkarkim auto Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 6.0 km Gërmim themele e plinta b~2m, ekskavator me goma, kova 0.25m ³ shkarkim auto Gërmim e mbushje dheu me krah kategoria III për themele, h = 1.5m Gërmim +mbulim dheu për kanal tokezimi S-0.12m ² F.V Gërmim dhe transport dheu për kanalet e tubove dhe pusetave Mbushje e ngjeshje dheu me krah F.V Gërmim dhe transport dheu për kanalet e tubove dhe pusetave Mbushje e ngjeshje dheu me krah | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.P-2 A | Ndertime civile dhe industriale | Mur me tulla të lehtësuara deri 8 m, LL.P. M-25 Nenshtrese zhavorri në themele (+mbushja nën dysheme) Shtrese betoni C 12/15 nën themele t=10cm | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

| | | | | |
|-----------|---|--|---------------|-----------------------------------|
| | | <p>Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m³ C 20/25 Trare themeli b/a C 20/25 monolit 40x60 Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 Shtrese betoni C 25/30 Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm Kunete Polipropilen 12x13 cm + zgare celiku (me oferte) Shtrese betoni C-16/20 i perpunuar me quarz t=5-10cm, ne ambjent teknik Shtrese betoni t=10 cm M-150 Trare themeli b/a C 25/30 monolit Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 25/30 F.V Hekur betoni periodik Mbushje me zhavor Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria IV Shtrese zhavori ne teritorin e ndertesave Shtrese betoni C 16/20 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit Bordura trotuari te parapergatitura Shtrese rere ne teritorin e ndertesave Zgare gize tip grille per kunete betoni 20 cm Soleta te plota b/a C 20/25 per stolat e jashtme F V hekur betoni periodik Ø 6- 10 mm per stolat e jashtme F.V Shtrese rere F.V Shtrese rere</p> | | |
| N.P-3 A | Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash | <p>Shtrese termoizolimi me polisterol t=10 cm Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=10cm + rrjete + suva Suvatim me grafiato h > 4 m</p> | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.P-12 A | Punime të inxhinerisë së mjedisit | <p>Kosha meturinash ne ambientin e jashtme F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander" F.V mbjelleje peme dekorative Bli Mbushje me Humus t=20 cm Mbjellje bari</p> | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.S- 1. A | Punime për prishjen e ndërtimeve | <p>Heqje dritare dhe vetrate Heqje dyer te brendeshme Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtresa betoni dhe pllaka Heqje tuba vertikale shkarkimi ujrave te shiut Heqje ulluku horizontale te ujrave te shiut Cmontim kangjelave dhe portave te jashtme dhe pergatitja per skrap Prishje muri b/a (I jashtem) Prishje shtresa betoni dhe pllaka trotuari Prishje catie me tjegulla</p> | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

| | | | | |
|----------|--|--|---------------|-----------------------------------|
| | | Prishje soleta b/a per ndertimin e kunetes | | |
| N.S- 2 A | Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre | Pilete dysHEMEJE d110 Tub i zinguar 1½ - Tub i zinguar 2" Tub i zinguar 2½ Bombul zjarri 6 kg pluhur 40% Tub pex al pex 16 Tub I zinguar 2½ Tub I zinguar M 2 Kolektor ¾" me 2 dalje ½" Pilete dysHEMEJE me grille Ø50 Bolier 80 Mates uji 2" Saracineske 2" tub ppr Ø50 SDR 6 tub ppr Ø63 - SDR 6 tub pex-al-pex 16 tub pex al pex 20 Kolektor ¾" me 4 dalje ½" Kolektor ¾" me 3 dalje ½" Rakord per mates F/M 21/2 me 2 " Filter " 2" Valvul per mos kthimin e ujit 2" Kollone hidranti 1m DN80 me dy dalje DN65 Berryll i flanaxhuar DN80 Kasete hidranti DN45 x 1 1/2" Fashete per sprinkleri 1 1/2" Fashete per sprinkleri 2 1/2" Grup I lidhjes me motopompe 2" me nje dalje Tub zinguar M 1½ Tub celik 1¼" Tub zinguar 1" Tub I zinguar 1/2" Tub bakri 6.35 (1/4) Tub bakri 9.52 (3/8) Tub bakri 12.7 (1/2) Tub bakri 15.87 (5/8") Tub 19.05 (3/4) Bombul zjarri 6 kg pluhur 40% Tub bakri Ø22 Armflex izoluese 22x13 Tub bakri Ø28 Armflex izoluese 28x13 | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

| | | | | |
|----------|--|--|----------------|-------------------------------------|
| | | <p>branch VRF-VRV Tub PP 32 Cajruet 1/2" Elektroda bakri Kolektor bronxi 1" me 6 dalje Paste 250g Kolektor M/F 1" me 4 dalje 1/2" Kasete kolektori 65x35 Panel 20mm 120x400 Pompe dranazh H=24-6.4m Q=65 m3/h Pompe H=32.5-25.2 m Q=1.2-5.4 m3/h Pompe H=44.6-14.3m Q=100-400 l/min</p> | | |
| N.S-4. B | <p>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese</p> | <p>Boje Vaji per siperfaqe metalik 2 duar Shtrese lluster çimento 1:2 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama Shtrese Avullizoluese gjeotekstil Shtrese stiropeton per pjerresi Shtrese lluster çimento 1:2 Shtrese me pllaka porcelanat importi Shtrese parketi laminat Shtrese pllaka mermeri t = 20 mm Shtrese parmaku e pragjesh pllaka mermeri t = 20 mm Hidroizolim banjash me dy shtrese mapej Hidroizolim dysHEME kati perdhe dhe amb teknik me dy shtrese mapej Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 Plintuse grez importi, h = 10 cm Plintuse mermeri h = 10cm Tavan kartonxhes kunderlageshtires Tavan me kartonxhes Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim tavani e muresh F V Dyer dritare d/alumini plastike dopio xham F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham Dere d/alumini pa xham, me mbushje d/a per banjo Vetrato xhami i temperuar F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re. F.V. Dere kundra zjarrit REI60 te pajisur me doreze antipanik dhe mekanizem mbylles Boje hidroplastike importi cilesi e I-re Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi, h=80~90cm Lyerje betoni me hyperdesimo F.V Kangjella dekorative hekuri me figuracion mesatare (Pa deren rreshqitese) F.V porte metalike dekorative rreshqitese Elektromotere per portat metalike me rreshqitje Boje Vaji per siperfaqe metalik 2 duar (me gjithë deren rreshqitese) Shtrese derrasa FM 4.0cm per stolat e jashtme</p> | 21-50 mln leke | Nuk e kalon vlerën 21-50 milion lek |

| | | | | |
|------------|--|--|---------------|-----------------------------------|
| N.S – 8 A | Ndërtimë parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri | Veshje fasade me alukobonde | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.S – 12 A | Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit | Radiator 600 212W Grile lineare 80x10 cm Ndares hidraulik DN65 21/2" 18m3/h Njesi e jashtme 28/31.5 kW Pajisje Kondicionimi 12000 btu Pompe riqarkulluese 3x400V Pompe riqarkulluese 3x400V Njesi e brendshme 2.8/3.2kW Kaldaje me pelet 291 kW Ene zgjerimi 200 l Tub PP 50 Tub PP 75 Tub PP 110 Tub PP 125 Tub PE-HD 63 Tub PE-HD 160 Stafa Ø110 Stafe Ø125 tub ppr Ø20 SDR 6 tub ppr Ø25 SDR 6 tub ppr Ø32 SDR 6 tub ppr Ø40 SDR 6 | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.S – 14 A | Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. | F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 1.5 mm ² F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 2.5 mm ² F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 4 mm ² F.V Tub fleksibel Ø 20mm F.V Tub fleksibel Ø 25mm F.V Tub fleksibel Ø 32mm F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida PT-5 F.V. kuti suport pllaket 3 modular F.V. Celes elektrik 1polar 10A-250V F.V Ndricues LED 60x60cm 4000K 36W inkaso IP20 F.V.Panel elektrik plastik 48 module+aksesore F.V Kuti, suport, kapak, 4 module me kapak jashte murit Kabell FG16OR16 S=5x6mm ² Kabell FG16OR16 S=5x1.5mm ² Kabell FG16OR16 S=3x1.5mm ² Kabell FG16OR16 S=3x2.5mm ² F.V Panel Elektrik Kryesor - Kati Perdhe (K.E.K) Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=50mm ² i zhveshur Elektroda tokezimi 5x5x0.5 L=150 F.V priza shuko "Gevis" universal Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A F.V Automat termo/el.manj. 2P 220V, 16A | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

| | | | | |
|-----------|-----------------------|--|---------------|-----------------------------------|
| | | <p>Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm F.V Kamera IP Bullet 5MP Outdoor F.V Aksesore montimi (kuti, krah) F.V Hardware per NVR kompletuar me HDD, min 60 dite regjistrime 32 Chanel F.V HDD 8 TB F.V Switch me 12 porta GE PoE, managed (kamera, AP WiFi) F.V Rack 12 unit outdoor 60x60x60 F.V Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6 F.V Kabell FTP Cat6 skermo outdoor F.V Fiber multi mode Outdoor Furnizim Riprodhues muzike I amplifikuar (CD,RADIO,USB) perfshire aksesoret e montimit Furnizim Mixer me amplifikator te integruar, perfshire aksesoret e montimit ne rack I kompletuar gati per pune, Furnizim Artopalant tavanor jashte murit, IP65 per instalim te jashtem, EN54 100V , 10 W Furnizim Mikrofon me kontroll per 6 zona per njoftime manuale I kompletuar gati per pune F.V Kabell Fone I skermuar, Rezistent ndaj Zjarrit E90, 2x1.5 mm² F.V Ndricues H=2 mt F.V Kabell FG16OR16 S=5x2.5mm² F.V Kabell FG16OR16 S=3x1.5mm² F.V Tubo elektrik korregato Ø=63mm, tip i rende me rezistence te larte mekanike, per rrjetin e internetit F.V Kuti shperndarese C4 100x100x70 IP55 per instalim jashte murit F.V.Pusete plastike 30x30x30, kapak te forte RIC 1084</p> | | |
| N.S-18. A | Punime topogjeodezike | RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”.

(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licensat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa

rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjesisimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punes te parashikuara ne preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Specialist Ndertimi 1(nje)
- Elektracist 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Specialist te sistemit te kondicionimit ngrohes-ftohes 2 (dy)
- Specialist IT 1 (nje)
- Muratore/Suvatues 7 (shtate)
- Termoizolues 3 (tre)
- Bojaxhinj 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Pllakashtrues 4 (kater)
- Shtrues parketi 1 (nje)
- Hidroizolues 3 (tre)
- Mekanik 1 (nje)
- Saldator 2 (dy)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) manovrator dhe 5 (pese) shofere.

Per manovratorët deshmite e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme, dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen prill-qershor 2024 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen sëbashku me mjetet e marra me qera, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per shoferin leje drejtimi e vlefshme dhe te figurojne ne listepagesa te pakten për periudhen prill-qershor 2024 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund te disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevoje te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lyerje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e dyerve dhe dritareve, punimet hidraulike, punimet e tarracës, punimet e konstruksioneve metalike janë kërkuar 2 (dy) teknikë ndërtimi dhe 1 (nje) specialist ndertimi. Prania e dy teknikeve është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kërkesa për 2 (dy) Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti i prokurimit do të jetë i shtrirë në dy fronte njëkohësisht (rikonstruksioni i godinës dhe ndertimi shtese), dhe për këtë arsye duhet prania e dy punonjësve të tillë. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve dhe grafikun e punimeve.

-Për zbatimin e punimeve elektrike, të tilla si punimet për kuadrot elektrikë, sistemin e ndriçimit, sistemi i mbrotjtes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur te kuadri kryesor i godinës është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) elektriciste. Këta punëtorë të kualifikuar, merren me ndërtim, montim, instalim dhe riparim të sistemit elektrik në ndërtesa të ndryshme civile, objekteve social kulturore apo industriale etj. Elektricisti monton, instalon, riparon dhe mirëmban makineri dhe pajisjeve elektrike civile dhe industrial. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në preventivin total të punimeve, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve dhe faktin se do punohet në dy fronte njëkohësisht rikonstruksioni i godinës dhe ndertimi shtese.

-Për zbatimin e punimeve elektronike nga AK është kërkuar që OE të kenë të punësuar minimalisht 1 (nje) specialist IT. Ky punonjes i kualifikuar, merret me punimet për instalimin e rrjetit lan dhe telefonisë, sistemin e zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit, sistemin audio për sallat e leksioneve, sistemin CCTV, sistemin e sigurisë dhe kontrollit të hyrje – daljeve. Punimet elektronike dhe vëllimi i tyre përshkruhen në pikat përkatëse të projektit. Prandaj kërkesa për 1 (nje) specialist IT është një kërkesë tepër minimale.

-Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt janë kërkuar 2 (dy) hidraulikë merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes, sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure parashikon punime për montimin dhe instalimin e rrjeteve dhe pajisjeve të furnizimit me ujë dhe shkarkimeve, si dhe pajisjeve të ngrohje-ftohjes. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve dhe faktin se do punohet në dy fronte njëkohësisht rikonstruksioni i godinës dhe ndertimi shtese.

- Për zbatimin e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse në të gjithë vëllimet e objektit që do të ndërtohet nga AK është kërkuar që të angazhohet 2 (dy) instaluesë të sistemeve ngrohëse – ftohëse. Instaluesi dhe riparuesi i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse merret me parapërgatitjen, montimin dhe instalimin e kondicionerëve, kaldajave, paneleve diellore, çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje-ftohjes. Referuar prevetivit të punimeve janë shume pajisje për tu montuar, pa llogaritur pajisjet e vogla, tubat dhe rakorderitë. Kërkesa për 2 (dy) instalues të sistemeve ngrohëse – ftohëse në total për të gjithë vëllimet e objektit, është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punës duke patur parasysh që do punohet në dy fronte njëkohësisht.

-Për zbatimin e punimeve ku përfshihen projekti i rrjetit HVAC dhe projekti mekanik i mbrojtjes nga zjarri dhe parashikohen punime të tilla si punime për montimin e pajisjeve të kondicionimit dhe te kaldajes, si dhe punime për instalimin e sistemit MKZ dhe instalimin e pajisjeve respektive. Të tilla punime do të realizohen në të gjithë vëllimet e objektit që do restaurohet dhe shtesa që do te ndërtohet. Kërkesa që OE të ketë të punësuar 1 (nje) mekanik është kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve dhe faktin që do punohet në dy fronte njëkohësisht.

-Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të hidroizolimit. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me hidroizolimin për ambientet në kontakte me ujin si tualetet etj, hidroizolimin e tarracave.Për realizimin e punimeve të tilla në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet paralelisht, kërkesa që OE të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) hidroizolues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punës.

-Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të termoizolimit. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me termoizolimin për ambientet si termoizolimin e tarracave.Për realizimin e punimeve të tilla në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet paralelisht, kërkesa që OE të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) termoizolues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e punës.

-Punimet e muratorës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë mureve në vëllimet që ndërtohen dhe në vëllimin që rikonstruktohet, duke qenë se hapsirat e brenshme në vëllimin që rikonstruktohet do të rikonceptohen tërësisht. Vëllimi i këtyre punimeve është shumë i madh dhe realizimi i tyre duhet të kryehet nga punëtorë të kualifikuar. Muratorët, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dymëve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dymëve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj.

Kërkesa për 7 (shtate) muratorë/suvatues është minimale në raport me vëllimin e punës.

-Për punimet e bojatisjeve të brendshme dhe të jashtme të të gjithë mureve dhe tavanëve AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) bojaxhi. Bojaxhiu dhe të tjerë që lidhen me to merret me përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, përgatitjen e

materialeve që do të përdoren për lyerje, lyerjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të ndryshme sipas projekteve dhe kërkesave të klientëve. Ai mund të vendosë shtresa të materialeve mbrojtëse dhe dekorative të ngjashme ose të mbulojë mure të brendshme dhe tavane të ndërtesave me tapiceri dhe materialeve të ndryshme si: letër, mëndafsh, stof e të tjera. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit.

-Shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dyshemeve ose mbulojnë dyshemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dyshemeve të kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkëlqime të shkallëve, shtrimin me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv përfshijnë sipërfaqe të mëdha.

Pra për realizimin e kyre zerave AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 4 (kater) pllakashtruesish dhe 1 (nje) shtrues parket/laminati. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet paralelisht.

- Punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, prevetivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe pregatitja e kallëpëve. Krahas punimeve të betonit dhe betonarmesë parashikohet edhe ndërtimi i skelave, të cilat krahas strukturave metalike parashikojnë edhe shumë punime druri. Për realizimin e punimeve të tilla është e nevojshme që OE të zotërojë minimalisht 2 (dy) karpentier.

-Për saldimin e elementëve metalikë nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 2 (dy) saldatori. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime të strukturave metalike, siç janë stolat dekorative, porta metalike për territorin e jashtëm, konstruksione metalike etj. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit.

-Për zbatimin e punimeve të konstruksioneve metalikë nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 3 (tre) hekurkthyes. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime të strukturave metalike, siç janë stolat dekorative, porta metalike për territorin e jashtëm, konstruksione metalike si dhe kthimin e hekurit të domosdoshëm për strukturat b/a janë kërkuar minimalisht 2 (dy) hekurkthyes.

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. *Bazuar në kater elementet e struktureve të kostos (material, punëtori, makineri, transport).* Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.10 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

| | | |
|--|--------|------------------------|
| Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 7 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Kamion 3.5 - 7.5ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |

| | | |
|--|---------|------------------------|
| Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autovinc me kosh | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Vinc kulle deri 5 ton | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autobetoniere | cope 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autopompe betoni | cope 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Eskavator | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Fadrom (kove para dhe krahe mbrapa) | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Rrul me vibrim | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Betoniere kantier | copë 3 | Ne pronesi ose me qera |
| Matrapik | cope 2 | Ne pronësi ose me qira |
| Vibrator thellesie | cope 2 | Ne pronësi ose me qira |
| Depozite 2000-5000 lit | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Balone ndricimi | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Saldatrice | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Makineri per testime me presion uji | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Aparat elektrofuziv | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Skele | 1500 m2 | Ne pronesi ose me qera |
| Rrjete | 1500 m2 | Ne pronesi ose me qera |
| Pompe suvatimi | cope 2 | Ne pronësi ose me qira |
| Pompe per lyerje | cope 1 | Ne pronësi ose me qira |

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.8.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit

kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentim.: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet

e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

ISO 9001:2015 - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë". ISO 9001:2008 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 2008 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se Oe ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

ISO 45001 : 2018 - Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës

Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

ISO 14001:2015 - Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

2.4.2 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike

- Materialet e rrjetit ngrohes (HVAC)
- Materialet e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ)
- Materiale durale
- Materiale hidroizoluese
- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)
- Materiale kolle, llac, fino
- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka, Laminat
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me "mall" sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.4.3 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e mëposhtme duhet të paraqiten Skedat teknike/kataloge të shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore të akredituar dhe Çertifikatë Konfirmimit CE/Deklarata Performance lëshuar nga prodhuesi:

1. PUNIMET ELEKTRIKE

- **Kabell FG16OR16** Kabllot FG16OR16-0,6/1 duhet të jete sipas standardeve: CEI 20-13 IEC 60502-1 ose ekuivalente, CEI UNEL 35318-35322-35016 ose ekuivalente; EN 50575:2014 + EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duhet të jete i klasit 5. Tensioni nominal U_0 duhet të jete 600V (AC). Tensioni nominal U duhet të jete 1000V (AC). Tensioni i tetimit duhet të jete 4000V. Tensioni maksimal U_m duhet të jete 1200V (AC). Temperatura maksimale e operimit duhet të jete 90 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet

te jete 250 °C per seksione deri ne 240mm² Temperatura minimale e operimit duhet te jete -15 °C. Forca maksimale ne terheqje nuk duhet te jete me pak se 50N/mm².

- **Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V.** Kabllot N07V-K apo te njohur me kodin e ri FS17 450/750V duhet te jene sipas standardeve CEI 20-14, CEI UNEL 35716-35016 ose ekuivalente, CEI EN 50525 ose ekuivalente, EN 50575:2014 + EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duhet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U₀ duhet te jete 450V dhe tensioni nominal U duhet te jete 750V. Tensioni i testimit duhet te jete 3000V ndersa tensioni maksimal duhet te jete 1000V. Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 70 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 160°C. Temperatura minimale e operimit duhet te jete -10 °C dhe temperature minimale e instalimit duhet te jete 5°C.
- **Automat;** Ndërprerës termo-magnetik për kontroll, numri i poleve 2 dhe 4, Kurba e ckyces: C., Rrymat maksimale te shkycjes (Icu) : 10kA, Tensioni i izolimit duke u bazuar ne standartin IEC/EN 60664-1 ose ekuivalente: 440 V. Frekuenca 50/60 Hz. Tipi i mbrojtjes: IP20 Te plotesoje Standartin IEC / EN 60898-1 ose ekuivalente dhe IEC/EN 60947-2 ose ekuivalente.
- **Prize 2P+N/16A/ Prize bivalente 2P+N/16A** Te plotesoje standartin CEI 23-50-II ose ekuivalente.
- **Tub fleksibel PVC, djegje pa flake dhe emetim te ulet gazi, tip i rende, Ø=20mm - 32 mm.**Te gjeje perdorim ne te gjitha kategorite e instalimeve elktrike. Te plotesoje Standartin EN 61386-1 ose ekuivalente.
- **Ndricues LED i jashtëm** Me driver LED te integruar. Fluksi i ndricimit: 85lm/w. Eficensa e ndricimit: 120lm/W Te plotesoje Standartin EN 60598 ose ekuivalente.
- **Ndricues LED Panel inkaso** Me driver LED te jashtem, Faktori i fuqise: >0.95. Fluksi i ndricimit: 3600-4400lm. Eficensa e ndricimit: 120lm/W Te plotesoje Standartin EN 60598 ose ekuivalente.
- **2. KALDAJE ÇELIKU (GRUP TERMIK)**
 - a. Kaldaje, Model KOR 3G 400;Fuqia ngrohëse 465 kw; Diametri i oxhakut 250 mm; Diametri i tubit feed/return dn 65 inch; Diametri i lidhjes së tankeve të zgjerimit 3/4"; Gjerësia e çelikut e trupit të brendshëm të kazanit 5 mm; Gjerësia e çelikut e trupit të jashtëm të kazanit 3 mm; Presioni operativ 3 bar; Presioni i testit 5 bar; Fuqia elektrike e motorit 0.55 kw; Totali i energjisë elektrike 2.2 kw; Shkalla e mbrojtjes elektrike ip 20; Tensioni dhe frekuenca 220/50 v/hz; Intervali i vendosjes së temperaturës 30-90 °c; Vëllimi i ujit 1250 l; Dimensionet : a- 850mm b-2200 mm h-1850 mm; Madhësia e brendshme e furrës gjerësia x lartësia 800x580mm; Thellësia e furrës 1830mm; Pesha net 2300 kg.
 - b. Pompe qarkullimi teke per qarkun primar INVERTER(kaldaja); prurja 38.5 m³/h;; prevalenca 60 kPa; lidhjet DN 65, Pn 6; fuqia elektrike 1.5 kW, rryma 4.8 A; ushqimi 3F/400V/50Hz.
 - c. Pompe qarkullimi binjake e terminaleve INVERTER ; prurja 17.5 m³/h; prevalenca 120 kPa; lidhjet DN 65, Pn 6; fuqia elektrike 2x1.5 kW, rryma 2x5.4 A; ushqimi 1F/230V/50Hz.
 - d. Pompe qarkullimi binjake e terminaleve INVERTER ; prurja 13.5 m³/h; prevalenca 120 kPa; lidhjet DN 65, Pn 6; fuqia elektrike 2x1.5 kW, rryma 2x5.4 A; ushqimi 1F/230V/50Hz.

- e. Pompe dozimi, me sistem dozimi konstant nga 0% deri ne 100%, te cilat sherbejne per trajtimin e ujit per sistemin e ngrohjes. Parametrat jane: Rregullim konstant nga 0-3 l/h ; Injektimi: 0.36 cc ; Kundra presion max.: 7 bar; Temperatura e ambientit: 5°C - 50°C; Voltazhi: 230 V; Fuqia elektrike: 12 W; Mates uji: DN65 4 impulse - 100 lit; Sebrator polietileni: 200 Lit
- f. Ndares hidraulik, per ndarjen e qarkut primar nga qarku sekondar: Materiali i trupit: çelik; Presion maksimal i punes: 10 bar; Temperatura: 0 ÷ 100°C ; Lidhjet me flanaxha: DN 80; Lidhja me kundra flanaxh: UNI 2278
- g. Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohjes te godines ekzistuese, dhe palestres ; Volumi 80 lit ; Diametri 400 mm; Lartesia 820 mm; P.max 6 bar T.punes -10÷99°C; Lidhja 3/4"
- h. Ena e zgjerimit te kaldajes eshte: Kapaciteti: 200 litra; Dimensionet: 600 mm; Lartësia: 812 mm; Presioni maksimal: 6 bar; Temperatura e sistemit: -10°C deri ne +99°C; Lidhja: Ø 3/4".

3. PUNIME MNZ

- a- **Kaset + hidrant zjarri i brendshëm.** Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe, me baze rezine. Dimensionet (400x600x200) mm konform En 671-22012, tub fleksibël Dn 45 konform En 14540 ose ekuivalente, Aksesorët: saraqineske ndërrprerëse 1½",
- b- **Fikëse zjarr pluhur karelato** Bombel e lyer me boje ngjyre te kuqe (RAL 3000) e levizshme me pluhur. Mund te perdoret per fikjen e zjarrit ne pajisjet elektrike si dhe rreth tyre pasi eshte jo percielle. Efektive ne fikjen e zjarreve qe perfshin klasa A e zjarrit. Kapaciteti Normal 4 - 12kg. Dimensionet Ø 140 x 765 mm. Te jete në përputhje me Standardin: EN 3-7 ose ekuivalente.

4. PUNIME BOJATISJE

- a- **Bojë Akrilike** Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike te paqëndrueshem (VOC), ku emetimi te jete jo më poshtë se KLASA "A+", si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftesine mbuluese te bojës, ku fuqia mbuluese te jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencen ndaj larjes.
- b- **Bojë Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA "A+", si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të.
- c- **Bojë vaji** Boja të jetë me bazë rezine alkide e cila i jep produktit mbulim të madh dhe rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë dhe e tretshme në ujë. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe metalike dhe druri. Natyra e lidhësit: Rezinë Alkide, Viskoziteti: 120 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente, Norma e hapjes: ≥ 10 m² / litër (me një shtresë), Peshë specifike: 1.3 ± 0.2 kg/litër - Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 80 g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 "Për

vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme.

5. PUNIME SHITESASH

- a- **Hidroizolues** Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji.
- b- **Kolle Speciale Antilagështirë** Ngjitës thiksotropik, elastik, i gatshëm për përdorim, me bazë shpërndarjen ujore të estereve poliakrilike dhe shtesa të veçanta kategoria D2TE sipas EN 12004 ose ekuivalente. Rezistent ndaj lagështisë, acideve të holluara, sipërfaqeve alkalike. Rezistencë të madhe fillestare dhe përfundimtare në ngjitje. Peshë specifike 1,22 Kg/lt Konsumi teorik: 3-5 kg/m²Djegshmëria: i padjegshëmRëshkitja horizontale ≤ 0,5 mm Rezistenca në shkëputje 1,5 N/mm². Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 12004:2007 +A1:2012 ose ekuivalente.
- c- **Pllakë shtrimi grez porcelanato**. Format 60/60 cm x 10mm, Porcelain . Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmangët rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishitjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes
- d- **Laminat** për mbulimin e dyshemese për përdorim të brendshëm Trashesia 8-10 mm Reagimi ndaj zjarrit Cfl-s1 Rezistenca termike 0,115 m²K/W Rezistenca rrotulluese - asnjë ndryshim/dëmtim i dukshëm pas 2500 rrotullimeve Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 14041:2008 ose ekuivalente.

6.PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

- a- **Suva (Llac mbushës)**- Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1 ose ekuivalente.
- b- **Fino** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike të kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente.
- c- **Stuko patinimi** - Stukoja e patinimit të jetë material i cili realizon një veshje plastike (akrilike) për sipërfaqe të ndryshme të mureve, me efekt mbushës dhe maskues duke krijuar një shtresë të trashë, e cila mbulon dëmtimet e mundshme të shkaktuara në sipërfaqet e mureve dhe njëkohësisht e mbron nga agjentet atmosferikë.Peshë specifike: 1.2 ± 0.2 kg/litër Rezistenca në ngjeshje: ≥ 4.5 MPa (N/mm²) Rezistenca në përkulje: ≥ 1.5 MPa (N/mm²) Forca në ngjitje: ≥ 0.8 MPa (N/mm²) Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalente Pjesa 1: Llaç për suvatim dhe stukim ose ekuivalentin e tij
- d- **Sistem Kapote** Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike të kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 ose ekuivalent.

7.PUNIME MURATURE

- a- **Polisteroli** Densiteti: 17 kg/m³-Forca ngjitese: > 0.15 N/mm²-Forca ngjeshese: > 0.15 N/mm²-Percjellshmeria termike: 0.036 W/mKμ value: 40-Format: 100 x 50 cm. Produkti duhet të përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 131631 ose ekuivalente.

8.PUNIME HIDRAULIKE

- a- **Tub multistrad** multistrad duhete te jete I perbere me shume shtresa sipas standarteve:DIN 4726:EN 1246 ose ekuivalente.Tubat me shume shtresa duhet te jene te pershtatshem ne perdorimin e ujit te pijshem insatlime per ngrohje dyshemeje dhe radiatorve per ngrohje.Tubi duhet te kete 5 shtresa .Shtresa e brendshme PE-RT,shtresa ngjitese ,veshja alumin,shtresa ngjitese dhe shtresa e jashtem e bere nga PE-RT. Tubi duhet te kete keto karakteristika: Rezistenca kimike sipas:ISO 10358 Presioni maxsimal sipas ISO:10508 ose ekuivalente. Trashesia e veshjes se aluminit jo me evogel se 300 μ m Koficienti I zgjerimit termik 0.024mm/mK Perkulja me nje rreze jo me te vogel se 10 D. Tubat duhet te kene test raportet per cdo permase te artikujve sipas preventivit ku te vertetohen qe artikujt jane prodhuar e testuar ne lidhje me vetite fiziko-mekanike sipas standardeve.
- b- **Tuba PPR** Tubat PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer) . Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te cilet ndikojne ne ndryshimet sasiore dhe vetite e materialit si fleksibiliteti dhe fluiditeti .Tubat duhet te jene te prodhuara sipas EN ISO 15874-3 ose ekuivalente dhe te afta per te perballuar presione deri ne 25 bar ose 2.5 MPa. Dendesia e materialit Sipas standartit :ISO 1183 ose ekuivalente. Elasticiteti I tubit sipas:ISO 527-2/1 ose ekuivalente. Fortesia e tubit sipas :ISO 865 ose ekuivalente. Rezistenca ndaj goditjeve sipas:ISO 179 ose ekuivalente. Percueshmeria termike sipas:DIN 52612 ose ekuivalente. Tubat PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certikuar me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW).
- c- **Tubat e brinjezuar HDPE**. Tubat e brinjezuar HDPE duhet të jenë nga material polietileni, me densitet të lartë, në përputhje me standartin EN 13476 dhe EN 1610 ose ekuivalente.Tubat duhet te kene fleksibilitet te mire dhe veti te mira hidraulike dhe mekanike .Duhet te jene te pershtatshme per te gjitha punimet ne sisitemet e kullimit dhe ujerave te zeza per instalime nentokesore me rezistence te larte kimike sipas klasifikimit te standartit ISO 10358 ose ekuivalente.Gjatesia e tubave duhet te kete gjatesi standarte 6m dhe bashkimi i tyre te jete me bashkues me gomine EPDM ose SAG Tubat duhet te kene keto karekteristika. Materiali:HDPE Standarti:DIN 4262/1 ose ekuivalente Dendesia: >0.945 kg/m³ Moduli i elasticitetit:>800MPa Koficienti i zgjerimit termik linear:<0.17mm/m °K Koficienti i percjellshmerise termike:23 °C~0.36-0.5 W/mk Temperatura e Aplikimit:-40°C +60°C Rezistenca elektrike siperfaqesore:>1013 Ω Forca e unazes:Sipas standartit EN ISO 9969 ose ekuivalente. Ngjyra: E zeze Tubat hdpe te brinjezuar duhet te jene te certifikuar nga nje insitucion Nderkombetar ose Kombetar i akredituar,e cila te vertetoj qe tubat hdpe korrogato jane projektuar per kullime nentokesore nenpresion ne sisitemet e kanalizimeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e

cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te pajisjeve te propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjukojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kerkeses sipas pikes 9, garanton Autoritetin Kontraktor per cilesine dhe standartet e larta nderkombetare dhe te perditesuara sipas teknologjise se re dhe bashkekohore.

Gjithashtu në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt si edhe shërbejnë për ndërtimin e objektit, është marrë në konsideratë një test balancues dhe proporcional në përzgjedhjen e tyre. Kështu është vlerësuar se në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt janë marrë në konsideratë 2 faktorë, volumi i tyre, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi

të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorët dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, materialet e sipërcituara zënë një peshë specifike në punimet që do të kryhen në objekt, ndaj kërkesa lidhur me to është në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Ky kriter i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se shumica e produkteve të mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e nxenesve/mesuesve etj. Akoma më tej vlerësojme se kemi të bëjmë me një objekt arsimor ku përpunueshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasojë shëndetësore në shëndetin e nxenesve/mesuesve etj, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian. Gjithashtu, në përputhje dhe proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe peshës specifike të secilës prej mallrave që do të vendosen në objekt atëherë është parashikuar që për një pjesë prej tyre të dorëzohen vetëm katalogjet ndërsa për mallrat dhe paisjet të cilat kanë një ndikim të veçantë në mjedis si edhe ndikim të veçantë në shëndetin qytetareve, krahas katalogjeve të prodhuesit është kërkuar edhe dorëzimi i raport testeve zyrtare të lëshuar nga laboratorë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, kriteri i mësipërm nuk shfaq diskriminim mes operatorëve të cilët blejnë dhe ofertojnë për kryerjen e punimeve me produkte të gatshëm pasi dokumentacioni i kërkuar me siper disponohet nga cdo prodhues serioz vendas apo i huaj.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë pjese DST.

Njesia e Prokurimit: